



Dalës-Izlasna

Nr. -1-164

Data 24.09.2019

Br.

Datum

OBILIĆ-OBILIĆ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12,14.2 ,17 pika c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 3 pika 1.4 , neni 6 pika 1.2 , neni 8 pika 1.3 dhe neni 11 pika 3.1 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 nenit 44.1 dhe 47.3 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 të datës 25.04.2016 dhe neni 39 i Rregullorës së Punës së Kuvendit nr.I-95,dt.29.06.2018 dhe propozim vendimi i Kryearit ne II-885,dt:19.08.2019 , kërkesa e MAPL-së për rishqyrtim e ligjshmërisë së vendimi I-155 ,nr VI-020-948/7 dt .20.09.2019. Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajturë më datë 24.09.2019 mori këtë

VENDIM
PËRFUNDIMTAR PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË
PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË OBILIQIT NË ZONËN
KADASTRALE NË LLAZAREVË

I

Miratohet Vendim për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës , në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit "Kolegji Biznesi " me adresë Adresë : 10000 Prishtinë, Ulpianë, rr.Motrat Qiriazi, nr.29,

II

Sipas pikes I të këtij vendimi :

1. "Kolegji Biznesi " është shfrytëzues i pronave të paluajtshme të Komunës

Pronat e Komunës gjenden në zonën kadastrale Llazarevë Njësia Kadastrale Nr.00124-13, me sipërfaqe të përgjithshme prej **14591 m²**, Vend i quajtur "Harëdhia" zone-Rrurale, zk.Llazarevë sipas Planit Zhvillimor Komunal parcela në fjalë është Zonë Industriale, e evidentuar në Çertifikatën e Pronës në emër të P.SH.KUVENDI KOMUNAL OBILIQ . Sipas neni 11 pika 3.1 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092

- 3.Shrytëzimi i pronës do të jetë për 99 vjet nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi , pas përfundit te këtij afati pronat i kthehen titullarit .

- 4.Në pronën e paluajtshme të Komunës do të ndërtohet objekti për nevoja të "Kolegji Biznesi "

III

Dhënia në shrytëzim e pronave të paluajtëshme të cekur në pikën II , bëhet me kompenzim

IV

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë , të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shrytëzuesit të pronave të paluajtshme të Komunës

V

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtorati për Planifikim Urban, Pronë dhe Kadastër, Drejtorati për Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspektion.

VI

Obligohet Drejtoria e Planifikimit Urban , Kadastër dhe Pronë që pas përfundimit të zbatimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës të regjistrojnë në librat kadastral si prona të dhëna në shfrytëzim për periudhë afatgjatë.

VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokolit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

Kuvendi i Komunës së Obiliqit


Nr. I- 164 - , më 24 SHTATOR 2019

T'i dërgohet

- Kryetarit
- Kryesuesit
- MAPL
- DPUKP
- DMM
- DEZHF
- DI
- Palës
- Anëtarëve të Kuvendit
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Burim Gërguri



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Xhafer Gashi , Kryetar i Komunës së Obiliqit Burim Gërguri , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Adrijana Hodžić , Ministre e Administrimit të Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj , Sekretare e Përgjithshme në MAPL	
Nga:	Besim Myrtezani , U.D i Udhëheqësit të Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 18/09/2019 Nr. 020-948
Zyrtarët përgjegjës		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa , Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Ardita Latifi , Zyrtarë e lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë e aktit të komunës së Obiliqit	
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrit të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim përfundimtar Nr.155, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Llazarevë, ofertuesit "Kolegji Biznesi"
I miratuar më datë: 30.08.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.09.2019


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendim përfundimtar Nr.155, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Llazarevë, ofertuesit "Kolegjit Biznesi"	Ky vendim nuk është në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, për arsye se, në Preambulë, nuk është përfshirë, neni 11, Negocimi i ofertave nga Kryetari i Komunës, i Ligjit NR. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, për të kuptuar se cila nga e drejta e negocimit është shfrytëzuar për negocim. Po ashtu, pika III, e vendimit, ku thuhet se dhënia në shfrytëzim e pronave të paluajtshme të cekur, në pikën II, bëhet me kompensim sipas Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, duhet të hiqet, për arsye se bie në kundërshtim me Ligjin NR. 06/092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndër marrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Datës-Izbori

Nr.

Br.

OBILIQ-OBILIQ

Data

Datum



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12,14.2 ,17 pika c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 3 pika 1.4 , neni 6 pika 1.2 , neni 8 pika 1.3 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 nenit 44.1 dhe 47.3 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 të datës 25.04.2016 dhe neni 39 i Rregullorës së Punës së Kuvendit nr.I-95,dt.29.06.2018 dhe propozim venidmi i Kryearit nr II-885,dt:19.08.2019 , Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajturë më datë 30.08.2019 mori këtë:

VENDIM

PËRFUNDIMTAR PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË OBILIQIT NË ZONËN KADASTRALE NË LLAZAREVË

I

Miratohet Vendim për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës , në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit "Kolegji Biznesi " me adresë Adresë : 10000 Prishtinë, Ulpianë, rr.Motrat Qiriazi, nr.29,

II

Sipas pikës I të këtij vendimi :

1. "Kolegji Biznesi " është shfrytëzues i pronave të paluajtshme të Komunës

Pronat e Komunës gjenden në zonën kadastrale Llazarevë Njësia Kadastrale Nr.00124-13, me sipërfaqe të përgjithshme prej **14591 m²**, Vend i quajtur "Harëdhia" zone-Rrurale, zk.Llazarevë sipas Planit Zhvillimor Komunal parcela në fjalë është Zonë Industriale, e evidentuar në Çertifikatën e Pronës në emër të P.SH.KUVENDI KOMUNAL OBILIQ . Sipas neni 11 pika 1,2,3 dhe 3.1 dhe 3.2 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092

3.Shfrytëzimi i pronës do të jetë për 99 vjet nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi , pas përfundit të këtij afati pronat i kthehen titullarit .

4.Në pronën e paluajtshme të Komunës do të ndërtohet objekti për nevoja të "Kolegji Biznesi "

III

Dhënia në shrytëzim e pronave të paluajtshme të cekur në pikën II , bëhet me kompenzim Sipas Rrgullorës për Tarifa ,Ngarkesa dhe Gjoha Komunal ne fuqi .

IV

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë , të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shryetëzuesit të pronave të paluajtshme të Komunës

V

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtorati për Planifikim Urban,Pronë dhe Kadastër,Drejtorati për Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspektion.

VI


Obligohet Drejtoria e Planifikimit Urban , Kadastër dhe Pronë që pas përfundimit të zbatimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës të regjistrojnë në librat kadastral si prona të dhëna në shfrytëzim për periudhë afatgjatë.

VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokolit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

Kuvendi i Komunës së Obiliqit
Nr. I- 166 - , më 30 Gusht 2019

T'i dërgohet
-Kryetarit
-Kryesuesit
-MAPL
-DPUKP
-DMM
-DEZHF
-DI
-Palës
-Anëtarëve të Kuvendit
-Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri
Burim Gërguri

